

KONTRATE DHURIMI E KUOTAVE TE SHOQERISE "HERON ONLINE CONSULTANCY SERVICES" SH.P.K

Sot me daten 24/11/2021, nenshkruhet kjo kontrate dhurimi kuotash nga Znj. Hanaa Yousef Sabri, Znj. Dalia Abdelhamid Darwish, Z. Adelhamid Mahmoud Darwish, ortake te shoqerise "Heron Online Consultancy Services" me seli ne Tirane dhe Znj. Inji Abdelhamid Darwish ortake e re e shoqerise.

NENI 1 PALA DHURUESE

Znj. Hanaa Yousef Sabri, ortake me 33.333 % te kapitalit te shoqerise "Heron Online Consultancy Services ", zoteruese e 1 kuote me nje kapital 33.333 Leke.

Znj. Dalia Abdelhamid Darwish, ortake me 33.333 % te kapitalit te shoqerise "Heron Online Consultancy Services ", zoteruese e 1 kuote me nje kapital 33.333 Leke.

Z. Adelhamid Mahmoud Darwish, ortak me 33.333 % te kapitalit te shoqerise "Heron Online Consultancy Services ", zoterues i 1 kuote me nje kapital 33.333 Leke.

NENI 2 PALA PRANUESE E DHURIMIT

Znj. Inji Abdelhamid Darwish, ortake me 25% te kapitalit te shoqerise "Heron Online Consultancy Services ", zoteruese i 1 kuote me nje kapital 25 Leke.

NENI 3 BAZA LIGJORE

1. Kjo kontrate hartohet ne baze dhe per zbatim te vullnetit te lire dhe te pavarur te paleve percaktuar ne nenin 1 dhe nenin 2 si mesiper.
2. Kjo kontrate hartohet edhe ne baze dhe per zbatim te:
 - a) Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe ne vecanti nenit 761, nenit 762 te tij;
 - b) Statutin e shoqerise "**Heron Online Consultancy Services** "SH.P.K;
 - c) Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ne vecanti neni 73 dhe vijues te tij;
 - d) Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "**Heron Online Consultancy Services** "SH.P.K



NENI 4 OBJEKTI

1. Kjo kontrate ka per objekt dhurimin e 1 kuote qe perben 25 % te vleres se kapitalit themeltar, ekuivalente ne 25 Lek, qe zoterojne palet dhuruese ne kapitalin e shoqerise "**Heron Online Consultancy Services "SH.P.K** dhe jane prone e pales dhuruese dhe gezojne te gjitha te drejttat qe lidhen me to.
2. Pala pranuese e dhurimit i pranon pales dhuruese 25 % (njezet e pese perqind) te kuotave te kapitalit te saj ne shoqerine "**Heron Online Consultancy Services " SH.P.K**

NENI 5 DETYRIMET E PALEVE

1. Detyrimet e pales dhuruese:

- a) Marrin persiper dhe deklarojne se jane pronare 100 % te kuotave ne shoqerine "**Heron Online Consultancy Services " SH.P.K**, dhe nga keto kuota 25% ia dhurojne Pales Pranuese te Dhurimit.
- b) Garantojne palen Pranuese te dhurimit, se keto kuota jane te lira nga cdo barresim dhe detyrim karshi te tretteve dhe per cdo pretendim qe mund te ngrene te trette per cenimin e te drejtese se pronesis se pales pranuese te dhurimit (eviksjon), ne jemi te gatshem dhe te detyruar te paraqitemi menjehere me kerkesen e pales pranuese te dhurimit dhe te cdo personi tjetet te trete, qe pretendon mbi keto kuota, para gjith e organeve gjyesore dhe administrative per te mbrojtur te drejett e tij, si pronar i ligjeshem i ketyre kuotave pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

2. Detyrimet e pales pranuese te dhurimit:

- a) Pala pranuese ka marre ne dorezim kuotat, duke mos patur asnje verejtje sipas dokumentit ligjor.

3. Detyrimet dy paleshe:

- a. Palet kontraktuese deklarojne se te gjitha detyrimet e pershkruara me lart dhe te gjitha ato qe burojne nga kjo kontrate dhurimi jane realizuar prej tyre dhe ata nuk

kane asnje detyrim te ndersjellte midis tyre.

- b. Palet kontratuese deklarojne se kuotat jane marre ne dorezim nga pala pranuese te dhurimit ne gjendjen egzistuese dhe ata nuk ka asnje pretendim ne lidhje me kete veprim.

NENI 6 PASOJAT TRANZITORE TE KALIMIT TE AKSIONEVE

1. Pala dhuruese si dhe pala pranuese jane bashkerisht pergjegjes ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave objekt i kesaj kontrate.
2. Pergjegjesia solidare e pales dhuruese dhe pales pranuese ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave objekt i kesaj kontrate fillon nga casti i kalimit te kuotave nepermjet nenshkrimit te kesaj kontrate dhe perfundon me regjistrimin e ketij kalimi ne perputhje me dispozitat e ligjit **Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"** i ndryshuar.

NENI 7 EFEKTET E KONTRATES

1. Kalimi i pronesis se aksioneve nga pala dhuruese tek pala pranuese ne peruthje me percaktimet e kesaj kontrate perfundon me regjistrimin e kesaj kontrata prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit **Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"** i ndryshuar.
2. Kalimi i kuotave sipas kesaj kontrate regjistrohet ne perputhje me dispozitat e ligjit **Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"** i ndryshuar.
3. Regjistrim i percaktuar ne piken 2 te ketij neni ka efekt deklarativ.

NENI 8 DISPOZITA E FUNDIT

Keshtu me firmosjen e kesaj kontrate nga palet kontraktuese, palet dhuruese qe jane dhe 3 ortakët e saj **Znj. Hanaa Yousef Sabri, Znj. Dalia Abdelhamid Darwish, Z. Adelhamid Mahmoud Darwish** mbeten ortakë me nga 25 % te kapitalit te shoqerise dhe **Znj. Inji Abdelhamid Darwish** behet ortakë te shoqerise me 25% te kapitalit te shoqerise keshtu qe me nga 25% te kapitalit secili **duke gezuar te gjithë te drejtat ligjore mbi keto kuota ne shoqerine, "Heron Online Consultancy Services " SH.P.K.**

Pas ketij dhurimi ortakë te shoqerise **"Heron Online Consultancy Services " SH.P.K** shpk do te jene si me poshte:



1. Znj. Hanaa Yousef Sabri zoteruese i 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise me vlere 25 leke
2. Znj. Dalia Abdelhamid Darwish zoteruese i 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise me vlere 25 leke
3. Z. Adelhamid Mahmoud Darwish zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise me vlere 25 leke
4. Znj. Inji Abdelhamid Darwish zoteruese i 1 kuote qe perfaqeson 25% te kapitalit te shoqerise me vlere 25 leke

PALA DHURUESE

Znj. Hanaa Yousef Sabri

Znj. Dalia Abdelhamid Darwish

Z. Adelhamid Mahmoud Darwish

PALA PRANUESE

Znj. Inji Abdelhamid Darwish



A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized, cursive script.

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized, cursive script.